



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 771/2 prot.,

Datë 12.04.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60961-03-01-2023, me objekt “Qendra e Kreativitetit faza II” me fond limit 17,708,780.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë
- Ankimues:** BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK
Rruga “Xhorxh Martini” Nr. 20, Godina 11 kateshe, Shk.2, kati 7
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Korçë
Bulevardi Shën Gjergji, L.12, Korçë

Në datën 11.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 771 prot., datë 11.04.2023 e BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të BOE “RSM Company” përfaqësuar nga dega e saj në Shqipëri shoqëria “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje dhe Hidro Company” dshh & Desaret Company” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“1. Ofertuesi nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.6 ku përcaktohet shprehimisht se : 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet; Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k (degë e shoqërisë së huaj RSM COMPANY) nuk ka dorëzuar dokumentacion që të vërtetojë se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit sipas përcaktimeve të bëra më sipër dhe në përputhje me përqindjen dhe punimet konkrete që ka marrë përsipër në Kontratën e bashkëpunimit. Kontrata me objekt Asfaltimi i rrugës Dol-Kusar-Goden-,Gjakove,Faza e II-të e zbatuar nga shoqëria RSM COMPANY sh.p.k nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit. 2. Bazuar në kontratën e bashkëpunimit shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U është caktuar si përfaqësuese e bashkimit të shoqërive “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k dhe “Desaret Company” sh.p.k , ku ndër të tjera është caktuar që të bëjë aplikimin për procedurën e prokurimit dhe ndjekjen e procedurave online. Për sa më sipër mbështetur , në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe në autorizimin e bërë para noterit datë 30.12.2022, është shoqëria “Rrugë sinjalistike mirëmbajtjeje dhe Hidro Company” sh.p.k, me NIPT L04803001U, ajo e cila duhet duhet të kishte aplikuar në APP (www.app.gov.al) për këtë procedurë prokurimi.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 12.04.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri